



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më 31.05.2018, dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimrregullorja për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimrregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;
4. Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim;
5. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Policisë së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizik;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francez të KFOR-it;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01- 060/01-012/655/18 më, 23.05.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuani në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eëë.prishtina-komuna.org>

